



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK**

---

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Nr.401/1Prot.

Shkodër, më 21.01.2019

**Lënda:** Jepet informacioni i kërkuar

---

**Rruga:** \_\_\_\_\_

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 737, datë 07. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 401, datë 10. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Në qendrat komunitare “Për Familjen” të ngritura dhe vëna në funksion nga Bashkia e Shkodrës, ofrojnë shërbimet staf i specializuar sipas dhe në përputhje me shërbimet që këto qendra ofrojnë.

Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik përbëhet nga 31 punonjës nga ku 7 janë pjesë e drejtorisë dhe 24 janë pjesë e qendrave komunitare.

Përzgjedhja e stafit të drejtorisë realizohet në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndërsa përzgjedhja e stafit të qendrave komunitare “Për Familjen” realizohet në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07. 1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Njoftimet apo aktivitetet që organizohen pranë qendrave komunitare “Për Familjen” publikohen në faqen e Bashkisë Shkodër në [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al) në platformën “Transparenca e Buxhetit” dhe në rrjetin social “facebook” të Bashkisë Shkodër dhe të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**

---